



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1020/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Adelinë Berisha, kandidatë për anëtarë të kuvendit komunalë në Malishevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Komisionerëve të Vendvotimeve, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Adelinë Berisha kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Malishevë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Adelina Berisha kandidate për anëtarë të kuvendit komunalë nga PDK-ja në Malishevë, në të cilën pretendon se në vendvotim 3031/02/D është manipuluar gjatë numërimit të votave sepse Adelina Berisha me numër 21 nga PDK aty i ka të afërmit e saj mbi 20 dhe poashtu aty ka votuar edhe njëri nga prindërit e saj dhe aty shënon që ka 0 vota, si dhe votuesit e kanë shtyrë ta bëjë këtë ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1020/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.